



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVES  
REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E KAÇANIKUT  
OPSTINA KAÇANIK



Komuna e Kaçanikut  
Opština Kaçanik  
Municipal Kaçanik

|           |              |         |         |
|-----------|--------------|---------|---------|
| Data      | 23.07/18     | Vendi   | Kaçanik |
| Nr. orig. |              | Numri   |         |
| 01. Nr.   | 060/0322/143 | Shtojcë |         |

**PËR: Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal,  
-Zyrës Ligjore-**

**NGA: Kryesuesi i Kuvendit të Komunës Kaçanik, Kemal Mërseli**

**Lënda: Dërgimi i Vendimeve të mbledhjes së VII (Shtatë) të Rregullt të Kuvendit të Komunës Kaçanik, mbajtur me 17 Korrik 2018.**

Bashkëlidhur me këtë Shkresë, u dërgojmë, Vendimet e Kuvendit të Komunës Kaçanik, nga mbledhja e VII (Shtatë) e Rregullt e Kuvendit të Komunës, mbajtur me datë: 17 Korrik 2018, dhe atë:

1. Rregullore Nr. 02/2018 për organizimin e punës në shkolla fillore të ulëta dhe të mesme të larta;
2. Vendimi për shfuqizimin e Vendimit 01Nr. 350/02-15509/18 30 Maj 2018 për ndryshimin e destinimit sipas Planit Zhvillimor Komunal të parcelës me Nr. 223-1 nga Zonë ndërtimore P+2 në zonë ndërtimore P+5, ZK Bob;
3. Vendimi për shfuqizimin e Vendimit 01Nr. 350/02-15507/18 i datës 30 Maj 2018 për ndryshimin e destinimit sipas Planit rregullativ të Zonës së parë dhe një pjese të Zonës së dytë të Parcelës Kadastrale Nr. 5161-1, ZK Kaçanik;
4. Propozim Vendimi për rishqyrtimin e Planit zhvillimor të Komunës Nr. 06-9849/2010 të datës 28.12.2010 dhe harmonizimin e tij me ligjin e Ligjit për planifikim hapësinor Nr. 04/L-174;
5. Vendimi për Aprovimin e Planit të veprimit për zbatimin e Rekomandimeve nga të gjeturat e Auditorit për pvf 2017;

Vendimet ua dërgojmë në afatin e përcaktuar ligjor, me qëllim të shqyrtimit të ligjshmërisë së tyre nga Zyra Ligjore e MAPL-së.

Me respekt!



Kryesuesi i Kuvendit  
Kemal Mërseli



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna Kaçanik  
Opština Kaçanik  
Municipality of Kaçanik

**01Nr. 350/02-21670/18**  
**Kaçanik, 17.07.2018**

Në bazë të nenit 12.1 dhe 14 lidhur me nenin 82.2 të Ligjit 03/L-040 –Për Vetëqeverisje Lokale( Gazeta Zyrtare Nr. 28/ 04 Qershor 2008), të nenit 53 të Ligjit Nr. 05/L- 031- për Procedurën e Përgjithshme Administrative ( Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 19/ 16 Qershor 2016), duke vepruar sipas Kërkesës së MAPL Nr. 020-665/9 të datës 28.06.2018, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e vet të mbajtur me datë: 17 Korrik 2018, mori këtë:

### **V E N D I M**

**PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMI 01Nr. 350/02-15509/18 I DATËS 30 MAJ 2018 - PËR NDRYSHIMIN E DESTINIMIT SIPAS PLANIT ZHVILLIMOR KOMUNAL TË PARCELËS NR. 223-1, NGA “ZONË NDËRTIMORE P+2” NË “ZONË NDËRTIMORE P+5”, ZK NË BOB**

1. Me këtë Vendim, **SHFUQIZOHET** Vendimi i Kuvendit të Komunës 01Nr. 350/02-15509/18 i datës 30 Maj 2018 për ndryshimin e destinimit sipas Planit Zhvillimor Komunal, të parcelës nga “ zonë ndërtimore P+2” në “ zonë ndërtimore P+5” në parcelën kadastrale **Nr. 223-1**, të evidentuar në certifikatën mbi të drejtat e pronës së paluajtshme P-70917008-00223-1, Zona Kadastrale Bob, në pronësi të Fatmir Livoreka.

2. Vendimi për shfuqizimin e Vendimit të përcaktuar si në pikën 1 të këtij Vendimi bëhet pas Kërkesës të MAPL të datës 28.06.2018 respektivisht konfirmimit të ligjshmërisë nga ministria e linjës- Ministria për Planifikim Hapësinor, për shkak së i njëjti bien ndeshë me dispozitat e Ligjit Nr. 04/L-174 për Planifikim Hapësinor.

3. Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës -MAPL, si dhe 7 ditë pas publikimit në Faqen Zyrtare të Komunës.


4. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset: Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit.

**Me këtë Vendim njoftohen:** Kryetari i Komunës, Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit( përmes kësaj drejtorie njoftohen organet tjera relevante) dhe Arkiva.





Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna Kaçanik  
Opština Kaçanik  
Municipality of Kaçanik

01Nr 350/02-21670/18

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d, nenit 14, paragrafit 14.1 të Ligjit Nr.03/L-040, për vetëqeverisje lokale, ligjit 04/L-174, Statutit të Komunës së Kaçanikut dhe shkresës përcjellëse Nr.020-665/9 të MAPL-së, drejtori i DUKMM-së bën këtë:

**PROPOZIM VENDIM PËR SHFUQIMZIM TË VENDIMIT TË KUVENDIT KOMUNAL 01.NR.350/02-15509/18**

**I**

Me këtë propozim vendim MIRATOHET kërkesa e DUKMM-së për shfuqizimin e vendimit të kuvendit komunal 01.Nr.350/02-15509/18

**II**

Sipas pikës I të këtij vendimi, shfuqizohet vendimi që ngastra kadastrale 223-1, të ketë destinim Zonë Ndërtimore P+5, dhe mbetet ashtu siq është e paraparë me Planin Zhvillimor Komunal në fuqi Zonë Ndërtimore P+2

**III**

Për zbatimin e këtij vendimi paraprak do të kujdesen : Kryetari I Komunës, Drejtoria Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit.


**Arsyetim**

Pasi që komuna e Kaçanikut, ka pranuar shkresën përcjellëse nga MAPL, e cila pas marrjes së mendimit nga ministria e linjës MMPH, kanë vlerësuar se akti i komunës është në kundërshtim me dispozitat e legjisacionit në fuqi.

Kryetari Z. Besim Hazi



Drejtori I DUKMM Ukshin Çallaku



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**  
*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*  
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*  
*Ministry of Local Government Administration*

Prishtinë, Datë: 28.06.2018  
Nr.020-665/9

**Për: Besim Ilazi**, Kryetar i Komunës së Kaçanikut  
**Kemajl Murseli**, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Kaçanikut

**Lënda:** Shkresë përcjellëse

Të nderuar,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar, **Vendimin 01Nr.350/02-15509/18** për ndryshimin e destinimit sipas planit zhvillimor komunal të parcelës kadastrale Nr.223-1, nga "Zonë ndërtimore P+2" në "Zonë ndërtimore P+5", i miratuar nga Kuvendi i Komunës së Kaçanikut dhe nënshkruar nga Kryesuesi i KK të Kaçanikut, me qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë.

Duke u bazuar në nenin 7 të Rregullores (QRK) Nr. 01/2016 Për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), me datë 11.06.2018, ka përcjellë aktin e lartshënuar për vlerësim të ligjshmërisë në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Bashkangjitur gjeni Raportin nga MMPH lidhur me vlerësimin e ligjshmërisë.

MAPL, kërkon nga Komuna që zyrtarisht të njoftohet lidhur me ndërmarrjen e veprimeve konkrete për rishqyrtimin e këtij akti.

Me respekt,

**Rozafa Ukimeraj**  
Sekretare e Përgjithshme e MAPL-së

Kopje: Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave  
Arkivit të MAPL-së



|                                                                                                                                                                                                                                                           |                                   |
|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------|
| REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIC OF KOSOVA<br>QEVERIA E KOSOVËS - VLADA E KOSOVËS - GOVERNMENT OF KOSOVA<br>MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR<br>MINISTARSTVO SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA<br>MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANNING |                                   |
| Num. i reg.<br>i aktit: 02                                                                                                                                                                                                                                | Num. i reg.<br>i aktit: 3413-2/18 |
| Num. i reg.<br>i aktit: 02                                                                                                                                                                                                                                | Num. i reg.<br>i aktit: 26.06.18  |
| Prishtine / 8                                                                                                                                                                                                                                             |                                   |

**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**

**Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor**  
**Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja**  
**Ministry of Environment and Spatial Planning**

|                |                                                                                                                                                     |
|----------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Për:           | Ivan Todosijeviq, Ministër në MAPL.<br>Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme në MAPL.                                                           |
| Cc:            | Njësia për Administrimin e dokumenteve në MAPL<br>Njësia për Administrimin e dokumenteve në Komunë<br>Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave |
| Përmes:        | Albena Reshitaj, Ministre e MMPH-së<br>Arben Çitaku, Sekretar i Përgjithshëm i MMPH-së                                                              |
| Nga:           | Sabrije Rama, U.D. Drejtor i Departamentit Ligjor,<br>Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor                                               |
| Lënda:         | Kërkesë për rishqyrtimin e ligjshmërisë                                                                                                             |
| Lloji i aktit: | Vendim i Kuvendit të Komunës                                                                                                                        |

I nderuar Ministër,  
E nderuar Sekretare,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 01/2016 për Shqyrtimin administrativ të Aktive të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive. Departamenti Ligjor i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

**Vendimi i Kuvendit të Komunës së Kaçanikut 01.Nr.350/02-15509/18, të datës 30.05.2018, për ndryshimin e destinimit sipas planit zhvillimor komunal të parcelës kadastrale Nr.223-1, nga "Zonë ndërtimore P+2" në " Zonë ndërtimore P+5"**

I miratuar me datë: 01.06.2018

I parashtruar për shqyrtim në MAPL me datë: 07.06.2018

I dërguar për shqyrtim në MMPH, me datë: 11.06.2018

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës **është në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi**. Mos pajtueshmëri të aktit të komunës të parashtruar për shqyrtim të ligjshmërisë janë si në vijim:

| Nr. | Formulimi në aktin e komunës                                                                                                                                                                     | Dispozita ligjore me të cilën akti i komunës është në kundërshtim.                                                                                                                                                                                                                                         |
|-----|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| 1.  | Vendimi 01.Nr.350/02-15509/18, datë 30.05.2018, për ndryshimin e destinimit sipas planit zhvillimor komunal të parcelës kadastrale Nr.223-1, nga "Zonë ndërtimore P+2" në " Zonë ndërtimore P+5" | 1. Vendimi 01.Nr.350/02-15509/18, datë 30.05.2018, për ndryshimin e destinimit sipas planit zhvillimor komunal të parcelës kadastrale Nr.223-1, nga "Zonë ndërtimore P+2" në " Zonë ndërtimore P+5", Komuna e Kaçanikut është në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr. 04/L-174 për Planifikim Hapësinor. |
|     | Vendimi                                                                                                                                                                                          | - Komuna nuk ka të drejtë të bëjë ndryshimin e destinimit të parcelës kadastrale Nr.223-1 nga "Zonë ndërtimore P+2" në "Zonë ndërtimore P+5", duke respektuar dokumentet e planifikimit hapësinor.                                                                                                         |

Bazuar në të cekurat më lartë, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, i propozon MAPL-së që të kërkojë nga Kuvendi i Komunës/Kryetari i Komunës që të ndërmarrin veprime konkrete që aktin e komunës ta harmonizojnë me dispozitat ligjore në fuqi, brenda 30 ditësh nga data e pranimit të kërkesës për rishqyrtim të aktit.

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, mbetet në dispozicion të MAPL dhe komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



**Komuna Kaçanik**  
Opština Kačanik  
Municipality of Kaçanik

**01Nr. 350/02-21700/18**  
**Kaçanik, 17.07.2018**

Në bazë të nenit 12.1 dhe 14 lidhur me nenin 82.2 të Ligjit 03/L-040 –Për Vetëqeverisje Lokale( Gazeta Zyrtare Nr. 28/ 04 Qershor 2008), të nenit 53 të Ligjit Nr. 05/L- 031- për Procedurën e Përgjithshme Administrative ( Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 19/ 16 Qershor 2016), duke vepruar sipas Kërkesës së MAPL Nr. 020-665/8 të datës 28.06.2018, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e vet të mbajtur me datë: 17 Korrik 2018, mori këtë:

#### **V E N D I M**

**PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMI 01NR. 350/02-15507/18 I DATËS 30 MAJ 2018- PËR NDRYSHIMIN E DESTINIMIT SIPAS PLANIT RREGULLATIV TË ZONËS SË PARË DHE NJË PJESE TË ZONËS SË DYTË TË PARCELËS NR. 5161-1, ZK KAÇANIK**

1. Me këtë Vendim, SHFUQIZOHET Vendimi i Kuvendit të Komunës 01Nr. 350/02-15507/18 i datës 30 Maj 2018 për ndryshimin e destinimit sipas Planit rregullativ të Zonës së Parë dhe një pjesë të Zonës së dytë të Parcelës Kadastrale **Nr. 516-1**, nga “ rekreativo – sportive “ në “afarizëm – industriale”, e evidentuar në Certifikatën mbi të drejtat e pronës së paluajtshme P-70917048-00516-1, Zona Kadastrale Kaçanik, në pronësi të Mevlude Dushkaja.
2. Vendimi për shfuqizimin e Vendimit të përcaktuar si në pikën 1 të këtij Vendimi bëhet pas Kërkesë të MAPL të datës 28.06.2018 respektivisht konfirmimit të ligjshmërisë nga ministria e linjës- Ministria për Planifikim Hapësinor, për shkak së i njëjti bien ndeshë me dispozitat e Ligjit Nr. 04/L-174 për Planifikim Hapësinor.
3. Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës -MAPL, si dhe 7 ditë pas publikimit në Faqen Zyrtare të Komunës.
4. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset: Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit.


**Me këtë Vendim njoftohen:** Kryetari i Komunës, Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit( përmes kësaj drejtorie njoftohen organet tjera relevante dhe Arkiva.



Kryesuesi i Kuvendit  
Kemar Mërseli



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna Kaçanik  
Opština Kaçanik  
Municipality of Kaçanik

01Nr 300/62-21709/18

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d, nenit 14, paragrafit 14.1 të Ligjit Nr.03/L-040, për vetëqeverisje lokale, ligjit 04/L-174, Statutit të Komunës së Kaçanikut dhe shkresës përcjellëse Nr.020-665/8 të MAPL-së, drejtori i DUKMM-së bën këtë:

**PROPOZIM VENDIM PËR SHFUQIMZIM TË VENDIMIT TË KUVENDIT KOMUNAL 01.NR.350/02-15507/18**

**I**

Me këtë propozim vendim MIRATOHET kërkesa e DUKMM-së për shfuqizimin e vendimit të kuvendit komunal 01.Nr.350/02-15507/18

**II**

Sipas pikës I të këtij vendimi, shfuqizohet vendimi që ngastra kadastrale 516-1, të ketë destinim afarizëm, dhe mbetet ashtu siq është e paraparë me Planin Rregullues në fuqi Zonë Rekreativo-Sportive.

**III**

Për zbatimin e këtij vendimi paraprak do të kujdesen : Kryetari I Komunës, Drejtoria Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit.


Arsyetim

Pasi që komuna e Kaçanikut, ka pranuar shkresën përcjellëse nga MAPL, e cila pas marrjes së mendimit nga ministria e linjës MMPH, kanë vlerësuar se akti i komunës është në kundërshtim me dispozitat e legjisacionit në fuqi.



Kryetari z. Besim Ilazi

Drejtori I DUKMM Ukshin Çallaku



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**  
*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*  
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*  
*Ministry of Local Government Administration*

Prishtinë, Datë: 28.06.2018

Nr.020-665/8

**Për: Besim Ilazi, Kryetar i Komunës së Kaçanikut**  
**Kemajl Murseli, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Kaçanikut**

**Lënda: Shkresë përcjellëse**

Të nderuar,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar, **Vendimin 01Nr.350/02-15507/18 për ndryshimin e destinimit sipas planit rregullativ**, i miratuar nga Kuvendi i Komunës së Kaçanikut dhe nënshkruar nga Kryesuesi i KK të Kaçanikut, me qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë.

Duke u bazuar në nenin 7 të Rregullores (QRK) Nr. 01/2016 Për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), me datë 11.06.2018, ka përcjellë aktin e lartshënuar për vlerësim të ligjshmërisë në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Bashkangjitur gjeni Raportin nga MMPH lidhur me vlerësimin e ligjshmërisë.

MAPL, kërkon nga Komuna që zyrtarisht të njoftohet lidhur me ndërmarrjen e veprimeve konkrete për rishqyrtimin e këtij akti.

Me respekt,

**Rozafa Ukimeraj**  
Sekretare e Përgjithshme e MAPL-së

Kopje: Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave  
Arkivit të MAPL-së



REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA  
BEVENDKENDISHTES - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVO  
MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPESINOR  
MINISTARSTVO SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA  
MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANNING

Num. i reg. 02  
Num. i reg. 02

Num. i reg. 3481-2/18  
Data 26.06.18

Prishtine / 8

**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**

**Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor**  
**Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja**  
**Ministry of Environment and Spatial Planning**

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal  
Ministartvo Lokalne Samoprave i Administracije  
Ministry of Local Government Administration

Data 26.06.2018

Num. i reg. 020-065/3

|                |                                                                                                                                                      |
|----------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Për :          | Ivan Todosijeviq, Ministër në MAPL<br>Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme në MAPL                                                              |
| Cc:            | Njësia për Administrimin e dokumenteve në MAPL<br>Njësia për Administrimin e dokumenteve në Komunë<br>Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave |
| Përmes:        | Albena Reshitaj, Ministre e MMPH-së<br>Arben Çitaku, Sekretar i Përgjithshëm i MMPH-së                                                               |
| Nga:           | Sabrije Rama, u.d.Drejtor i Departamentit Ligjor,<br>Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor                                                 |
| Lënda:         | Kërkesë për Rishqyrtimin e Ligjshmërisë                                                                                                              |
| Lloji i aktit: | Vendim i Kuvendit të Komunës                                                                                                                         |

I nderuar Ministër,  
E nderuar Sekretare,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 01/2016 për Shqyrtimin administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

**Vendimi i Kuvendit të Komunës së Kaçanikut 01.Nr.350/02-15507/18 të datës 30.05.2018, për ndryshimin e destinimit sipas planit rregullativ të zonës së parë dhe një pjesë të zonës së dytë.**

I miratuar me datë: nuk shihet data

I parashtruar për shqyrtim në MAPL me datë: 07.06.2018

I dërguar për shqyrtim në MMPH, me datë: 13.06.2018

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës **është në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi**. Mos pajtueshmëri të aktit të komunës të parashtruar për shqyrtim të ligjshmërisë janë si në vijim:

| Nr. | Formulimi në aktin e komunës                                                                                                                                                                 | Dispozita ligjore me të cilën akti i komunës është në kundërshtim.                                                                                                                                                                                                                |
|-----|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| 1.  | Vendimi i Kuvendit të Komunës së Kaçanikut 01.Nr. 350/02-15507/18 të datës 30.05.2018, për ndryshimin e destinimit sipas planit rregullativ të zonës së parë dhe një pjesë të zonës së dytë. | - Vendimi i Kuvendit të Komunës së Kaçanikut 01.Nr. 350/02-15507/18 të datës 30.05.2018, për ndryshimin e destinimit sipas planit rregullativ të zonës së parë dhe një pjesë të zonës së dytë, është në kundërshtim me dispozitat e Ligjit nr. 04/L-174 për Planifikim Hapësinor. |
|     | Vendimi                                                                                                                                                                                      | - Komuna nuk ka të drejtë të bëjë ndryshimin e destinimit të parcelave kadastrale 516 – I dhe të destinohet si zonë për afarizëm dhe industri, lokacioni i planifikuar të bëhet sipas dokumenteve të planifikimit hapësinor në fuqi.                                              |
|     |                                                                                                                                                                                              | - Destinimi apo shfrytëzimi tjetër, nuk lejohet përveq asaj që është paraparë me dokumentet e planifikimit hapësinor të miratuara nga niveli lokal.                                                                                                                               |

Bazuar në të cekurat më lartë, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, i propozon MAPL-së që të kërkojë nga Kuvendi i Komunës/Kryetari i Komunës që të ndërmarrin veprime konkrete që aktin e komunës ta harmonizojnë me dispozitat ligjore në fuqi, brenda 30 ditësh nga data e pranimit të kërkesës për rishqyrtim të aktit.

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, mbetet në dispozicion të MAPL dhe komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut  
Opština Kacanik  
Municipal Kacanik

01Nr. 350/02- 21705/18  
Kaçanik: 17. 07.2018 2018

Në bazë të nenit 12.2(d) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare Nr. 28/ 04 Qershor 2008), të nenit 10 të Ligjit Nr. 04/L-174 Ligjin për Planifikim Hapësinor (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 30/ 23 Gusht 2013), Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e vet të mbajtur më 17 Korrik 2018, mori këtë:

### V E N D I M

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR RISHQYRTIMIN E PLANIT ZHVILLIMOR KOMUNAL NR. 06-9849/2010 TË DATËS 28.12.2010 DHE HARMONIZIMIN E TIJ ME LIGJIN E PLANIFIKIMIT HAPËSINOR NR. 04/L-174.**


1. Me këtë Vendim, miratohet Propozim Vendimi i DUKMM për Rishqyrtimin e Planit Zhvillimor Komunal.
2. Plani Zhvillimor Komunal duhet të adaptohet me nevojat e Komunës së Kaçanikut, dhe të harmonizohet me Ligjin për Planifikim Hapësinor Nr. 04/L-174.
3. Me këtë Vendim, autorizohet Kryetari i Komunës së Kaçanikut t'i formoj grupet punuese për realizimin e këtij plani.
4. Ky Vendim hynë në fuqi 15 ditë nga dita e dërgimit të aktit në MAPL respektivisht 7 ditë pas publikimit në Faqen Zyrtare të Komunës.
5. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen; Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit.

Me këtë Vendim njoftohen: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe Arkiva.





Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna Kaçanik  
Opština Kaçanik  
Municipality of Kaçanik

01Nr 300/02-21705/18

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d, nenit 14, paragrafit 14.1 të Ligjit Nr.03/L-040, për vetëqeverisje lokale, ligjit për planifikim hapësinor 04/L-174, Statutit të Komunës së Kaçanikut, drejtori i DUKMM-së bën këtë:

**PROPOZIM VENDIM PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR RISHQYRTIMIN PLANIT ZHVILLIMOR KOMUNAL DHE HARMONIZIMIN E TIJ ME LIGJIN E PLANIFIKIMIT HAPËSINOR 04/L-174**

**I**

Me këtë propozim vendim MIRATOHET kërkesa e DUKMM-së për RISHQYRTIMIN e PZHK-së

**II**

Plani Zhvillimor Komunal, duhet të adaptohet me nevojat e Komunës së Kaçanikut dhe të harmonizohet me Ligjin për Planifikim Hapësinor 04/L-174.

**III**

Me këtë vendim autorizohet kryetari i komunës së Kaçanikut, që të formojë grupet punuese për realizimin e këtij vendimi.

**IV**

Për zbatimin e këtij vendimi paraprak do të kujdesen : Kryetari I Komunës, Drejtoria Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit.

Kryetari z. Besim Ilazi

**Arsyetim:** Pasi që Plani Zhvillimor Komunal në fuqi, ka bërë mbi shtatë vite që është miratuar, është arritur koha e nevojshme sipas ligjit për shqyrtimin e tij. Gjithashtu plani zhvillimor komunal është i miratuar sipas ligjit për planifikim hapësinor 2003/14 dhe është parë nevoja që ky plan të harmonizohet me ligjin e ri Planifikim Hapësinor 04/L-174.

Drejtori I DUKMM Ukshin Çallaku





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova**  
**Republic of Kosovo**



**Kuvendi i Komunës Kaçanik**

**Skupština Opština**  
**Municipal Assambly**  
**01Nr.06-9849/2010**  
**Kaçanik, 28.12.2010**

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Planifikim Hapësinor 2003/14, të nenit 9 të Ligjit 03/L-106- Për Ndryshimin e Ligjit për Planifikimin Hapësinor, të Vendimit të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor Nr. 2709/10-ZSP-770/10 të datës: 08.12.2010, për dhënjën e Pëlqimit për Planin Zhvillimor të Komunës, të nenit 5,12.2(c) lidhur më nenin 17 dhe 40.2(l) të Ligjit Nr. 03/L-040 –Për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 6 dhe 34.5 të Statutit të Komunës si dhe Vendimit të Kuvendit të vitit 2007, për hartimin e Planit zhvillimor urban dhe Planit zhvillimor komunal të kuvendit në mbledhjen e vet të mbajtur më datë: 28.12.2010, mori këtë:

**V E N D I M**  
**PËR APROVIMIN E PLANIT ZHVILLIMOR KOMUNAL**

**I.**

Aprovohet Plani Zhvillimor Komunal 01Nr.06-9849/2010, më tekstin e mëtejshëm: (Plani Zhvillimor Komunal i Komunës së Kaçanikut).

**II.**

Plani zhvillimor komunal si në pikën I. të këtij Vendimi, siguron një bazë për zhvillim të çëndrueshëm për komunën e Kaçanikut, duke dhënë udhëzime konkrete për veprimet që duhet ndërmerren për përmirësimin e jetës së qytetarëve të komunës, duke ndikuar në ngritjen e kualitetit social, ekonomik dhe fizik të hapësirave përkatëse, përfshinë tërë teritorin e komunës së Kaçanikut (zonat urbane dhe rurale) për periudhën kohore 10 vjeqare-deri në vitin: 2020.

**III.**

Plani Zhvillimor Komunal, jep mundësi të modifikimit në të ardhmën pas një periudhe të caktuar kohore në bazë të kërkesave, kushteve dhe rrethanave që krijohen dhe jep mundësi të vazhdimësisë së planifikimit për të ardhmën.

**IV.**

Plani zhvillimor komunal, është hartuar nga DATA GIS CONSULTING, nga Prishtina, përmban gjithsej 300 faqe, dhe është pjesë përbërse e këtij Vendimi.

**V.**

Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga kuvendi i komunës.

**VI.**

Për zbatimin e këtij Vendimi, do të kujdeset Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit.

**VII.**

Me këtë Vendim njoftohen: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe Arkiva.

Kryesuesi i kuvendit,  
z. Xhelal Gashi



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut  
Opština Kaçanik  
Municipal Kaçanik

01 Nr. 470/04-21452/18  
Kaçanik, 17.07.2018

Në bazë të nenit 12.2(d) të Ligjit- Për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/ 04 Qershor 2008) të nenit 58 të Rregullores për Punë të Kuvendit të Komunës, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e vet të mbajtur me datë 17 Korrik 2018, mori këtë:

**VENDIM**  
**PËR APROVIMIN E PLANIT TË VEPRIMIT PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE**  
**NGA TË GJETURAT E AUDITORIT PËR PVF 2017**

1. Me këtë Vendim, Aprovohet Plani i Veprimit 01 Nr. 470/04-21452/18 -Për zbatimin e Rekomandimeve nga të gjeturat e Auditorit për PVF, 2017, i propozuar nga Kryetari i Komunës prej datës 06.07.2018.

2. Në Planin e Veprimit si në pikën 1 të këtij Vendimi, janë paraqitur; veprimet të cilat do t'i merr Kryetari i Komunës dhe zyrtarët tjerë përgjegjës për zbatimin e Rekomandimeve dhe afati kohor për të gjeturat e Auditorit për PVF 2017 dhe i njëjti është pjesë përbërëse e këtij Vendimi.

3. Ky Vendim hynë në fuqi 15 ditë nga dita e dërgimit të aktit në MAPL respektivisht 7 ditë pas publikimit në Faqen Zyrtare të Komunës.

4. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesën: Kryetari i Komunës dhe zyrtarët tjerë përgjegjës të përcaktuar si në Planin e Veprimit 01 Nr.470/04-21452/18 - Për zbatimin e Rekomandimeve nga të gjeturat e Auditorit për PVF, 2017.

**Me këtë vendim njoftohen:**

1. Kryetari i Komunës/ përmes Zyrës së Kryetarit, njoftohen zyrtarët përgjegjës –zbatues të Planit të Veprimit,
2. Drejtoria e Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit dhe
3. Arkivi.

